

STATUTI I SHOQERISE “EUROMONTANA” SHPK

STATUTI I SHOQERISE TREGTARE “EUROMONTANA” SHPK

Neni 1

Emri

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur:
“EUROMONTANA” sh.p.k.

Neni 2

Forma

Forma e shoqerise eshte ajo e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar (“SHPK”), sipas nenit 68 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008.

Shoqeria “EUROMONTANA” sh.p.k. zoterohet nga ortaket Altin Broshka dhe Kostantinos Karavelas, te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Neni 3

Data e themelimit

Shoqeria themelohet sot me date 03.07.2017 (tre korrik dymije e shtatembedhjete).

Neni 4

Ortaket

Ortaket e shoqerise jane:

- 1- Altin Broshka, i datelindjes 28.02.1983, nenshtetas shqiptar, banues ne Mollas – Bashkia Cerrik, i paisur me karte identiteti me nr. 027943051 leshuar ne date 02.12.2009, e vlefshme deri ne 01.12.2019.
- 2- Kostantinos Karavelas, i datelindjes 15.08.1958, nenshtetas grek, banues ne Nea Mountania, Kalkidhikis – Greqi, i paisur me pasaporte me nr. AK4366108 leshuar ne date 30.05.2014, e vlefshme deri ne 29.05.2019.

Neni 5

Selia

Selia e shoqerise eshte ne Mollas – Bashkia Cerrik, Shqiperi.

Adresa e sakte e selise eshte: Rruga Mollas - Selita, zona kadastrale 2717, pasuria nr.190/63, Mollas – Bashkia Cerrik, Shqiperi. Me vendim te asamblese se ortakeve, Selia e shoqerise mund te transferohet kudo brenda territorit te

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Republikes se Shqiperise, mund te hape ose te mbylle filiale, agjensi, perfaqesi brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 5/1

Zyra Qendrore

Zyra qendrore e shoqerise tregtare eshte ne rrethin e Elbasanit te qarkut Elbasan, te shtetit Shqiptar.

Ne zbatim te nenit 8 pika 2 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, shoqeria tregtare i nenshtrohet dispozitave te ketij ligji.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise

1. Eksport – import i imputeve bujqesore si dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice; eksport – import i farerave bujqesore si dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice; kryerja e zbatimit te punimeve te ndertimeve civile dhe industriale; tregtimi i pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme; eksport – import i materialeve te ndertimit si dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice; tregtimi i paisjeve elektrike dhe elektroshtepiake; tregtimi i materialeve hidraulike dhe hidrosanitare; tregtimi i veglave te punes, paisjeve dhe makinerive; shfrytezimi dhe perpunimi i materialeve inerte; shfrytezimi dhe perpunimi i mermereve dhe gureve dekorative; prodhimi i hidrosanitareve dekorative; tregtimi i produkteve ushqimore te konfeksionuara dhe te fresketa; katering; perpunimi dhe tregtimi i lendes drusore; perpunimi dhe tregtimi i mobiljeve; tregtimi i pjeseve te kembimit; prodhimi dhe tregtimi i konfeksioneve; eksport – import; studio projektuese; konsulence teknike; joint-venture; franchising.
2. Gjithashtu shoqeria mund te kryeje te gjitha veprimtarite tregtare dhe industriale, qe do te jene te nevojshme dhe te dobishme per permbushjen e objektit te shoqerise, mund te leshoje garanci reale ose personale edhe ne favor te te treteve, mund te zoteroje, mund te bleje ose te shese kuota, aksione, ose obligacione te shoqerive te tjera tregtare private ose publike, mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, bankare, aktive dhe pasive, te domosdoshme qe ne menyre direkte apo indirekte ndihmojne ne realizimin e objektit themeltar te shoqerise.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj dhe vepron si person juridik me personalitet te plote per te vepruar per nje kohe te pacaktuar.

Neni 8

Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre

Personi përgjegjes per administrimin dhe perfaqesimin e shoqerise eshte z.Altin Broshka, me keto te dhena identifikimi: lindur më date 28.02.1983 në rrethin Elbasan, banues dhe me adrese te sakte te deklaruar: Mollas – Bashkia Cerrik, me shtetesi Shqiptare.

Per efekt te komunikimit elektronik te parashikuar ne kete statut, nga ana e administratorit deklarohet kjo adrese e sakte e postes elektronike: karavelaskwstas@gmail.com.

Kompetencat e perfaqesimit jane te plota duke i dhene tager perfaqesuesit te perfaqesojë shoqerine ne te gjitha marredheniet juridike dhe per te gjitha veprimet juridike ku nje nga palet e ketyre marredhenieje juridike apo veprimeve juridike, shfaqet shoqeria "Euromontana" SHPK.

Z.Altin Broshka emerohet si administrator dhe perfaqesues i shoqerise ne marredhenie me te tretet, per nje afat prej 3 vitesh kalendarike, me te drejte ripërteritje.

Administratori i kesaj shoqerie afatin standart te emerimit e ka 3 vjet por shoqeria me vendimin e saj per emerimin e administratorit mund te caktojë nje afat me te shkurter.

Administratorit i takon rimbursimi i te gjitha shpenzimeve te kryera per llogari te shoqerise, shpenzime te vertetuara me dokumentacion perkates, si dhe caktimi i nje page ne përputhje me legjislacionin shqiptar dhe vendimin e Asamblese se ortakëve.

Neni 8/1

Ndalime dhe kufizime

- 1) Nese nje nga ortakët, gezon njekohesisht cilesine e administratorit dhe ortakut te shoqerise, bazuar ne nenin 7 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", administratorit si person fizik, i ndalohet kategorikisht te lidhe kontrata huaje apo garancie me shoqerine apo te lidhe kontrata huaje apo garancie me pale te treta ne emer te shoqerise dhe per llogari te tijin apo te nje personi tjeter.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

- 2) Ne lidhje me kontrata te tjera, pervec atyre te permendura ne piken 1 te ketij neni, parashikohet detyrimi qe nese do te kete kontrata per t'u lidhur midis administratorit dhe shoqerise "Euromontana" SHPK, perpilimi i kontratave do te behet prane zyrave te shoqerise, ku pervec kontratave, do te perpilohet nje procesverbal ne te cilin duhet te shprehet ne favor dhe ortaku tjetër. Cdo kontrate e perpiluar sipas kesaj pike, pa u marre miratimi me shkrim i ortakut tjetër, do te konsiderohet absolutisht i pavlefshem dhe do te ngarkoje me pergjegjesi personale administratorin per cdo dem material dhe ekonomik imediat ose te mevonshem.

Neni 9

Specimenti i nenshkrimt (firmes) se personit qe perfaqeson shoqerine perpara te
treteve

Altin Broshka
(nenshkrimi)

Neni 10

Vlera e kapitalit themeltar te nenshkruar

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise ka nje vlere prej 10000 leke.

Neni 11

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 2.

Neni 12

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 5000 leke.

Neni 13

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar

Pjesmarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar eshte:

- Ortaku Altin Broshka: 50%;
- Ortaku Kostantinos Karavelos: 50%;

Neni 14

Vlera dhe lloji i kontributit te ortakeve

-Vlera e kontributit te ortakut Altin Broshka eshte 5000 (pesemije) leke.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Lloji i kontributit te ortakut Altin Broshka eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

-Vlera e kontributit te ortakut Kostantinos Karavelas eshte 5000 (pesemije) leke. Lloji i kontributit te ortakut Kostantinos Karavelas eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

Neni 14/1

Kapitali fillestar i nenshkruar eshte paguar nga ortaket ne menyre te rregullt, plotesisht dhe rregullisht. Pergjegjësia e ortakeve eshte e kufizuar deri ne vleren e kuotes se kapitalit te nenshkruar.

Neni 15

Financimi i ortakeve

Ortaket ne dakordesi me administratorin mund te ndihmojne per mbulimin e nevojave financiare te shoqerise nepermjet derdhjes se kapitalit ne cfarolloj forme: derdhje mjetesh monetare ne llogarite bankare te shoqerise, mbulimi i humbjeve, shlyerje e detyrimeve te prapambetura te shoqerise, etj. Keto financime duhet t'i rikthehen mbrapsht ortakut i cili ruan te drejten e rikthimit mbrapsht te investimit ne cfarolloj momenti. Cdo ortak ka te drejte te ndihmoje edhe me perqindje te ndryshme nga kuotat e kapitalit ne poses.

Neni 16

Ndalimi i konkurrences

Ndalimi i permendur ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, mund te shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posaçem, te dhene nga ortakut tjetër sipas dispozitave te nenit 36 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

Neni 16/1

Ne mungese te nje shfuqizimi te parashikuar nga neni 16 i ketij statuti, ndalimi i konkurrences i parashikuar ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, mbetet ne fuqi deri ne 1 (nje) vit kalendarik pas humbjes se cilesive te permendura ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901.

Neni 17

Kalimi i kuotave

a) Kalimi i kuotave midis te gjalleve:

Konsiderohet transferimi i pjesmarrjes ne shoqeri nepermjet nje akti midis te gjalleve, aktet qe mund te jene akte me shperblim (oneroze) ose pa shperblim (lukrative).

1- Kushtezohet kalimi i kuotave te ortakeve te shoqerise "Euromontana" SH.P.K., me te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te shoqerise. Me qellim ushtrimin e te drejtes se parablerjes nga ortaket e tjere, duhet qe ortaku qe ka si qellim te kaloje kuotat e veta, te njoftoje te gjitha ortaket e tjere dhe administratoret me ane te nje letre me lajmerim marrje. Ne kete leter duhet te citoje emrin e blesit, cmimin, menyren e pageses dhe te gjitha kushtet e vendosura. Kjo leter vlen edhe si propozim per kalimin e kuotave ne favor te ortakeve te tjere, te cilet mund te pranojne propozimin dhe brenda 30 diteve nga marrja e njoftimit, duhet t'i pergjigjen me shkrim me lajmerim marrje propozuesit, ku te theksohet qellimi per blerjen e kuotave.

2- Ne rast kur te drejten per parablerje e ushtrojne me shume se nje ortak, atehere kuotat do te ndahen ne menyre te tille qe midis tyre raporti i pjesmarrjes ne kapitalin e shoqerise te ngeli i pandryshuar (me perjashtim kur ka nje akord te vecante midis tyre).

3- Ne rast se e drejta e parablerjes nuk eshte shfrytezuar nga asnje prej ortakeve te tjere te shoqerise, atehere per kalimin e kuotave sipas nenit 73 pika 1 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", duhet marre miratimi i ortakeve qe perfaqesojne 30 % te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise i cili autorizon keto kalime. Ne rastin kur ortaket e tjere ne menyre ekspicite ose ne menyre implicite, duke mos u pergjigjur brenda 30 diteve, nuk deshirojne te ushtrojne te drejten e parablerjes, atehere ortaku mund t'ia kaloje lirisht kuotat personit dhe me kushtet e cituara ne komunikimin per ortaket e tjere.

4- E drejta e parablerjes nuk ushtrohet ne rastin kur kalimi i kuotave ose te nje pjese te tyre behet midis bashkeshorteve, paraardhesve ose pasardhesve ne linje te drejte.

5- E drejta e parablerjes nuk ushtrohet edhe ne rastin kur kalimi i kuotave ose te nje pjese te tyre behet me kontrate te rregullt dhurimi te perpiluar prane nje noteri.

6- Fitimi apo kalimi i kuotave me kontrate, duhet te realizohet ne menyre te detyrueshme, ne cdo rast, me akt noterial.

b) Kalimi i kuotave ne rast vdekje (mortis causa):

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

- 1- Kalimi i kuotave ne rast vdekje behet lirisht ne favor te perfituesit legjitim.
- 2- Ne rast kur kalimi i kuotave i takon 2 ose me shume personave, kuotat do te ndahen midis tyre.
- 3- Kur pasardhesit kerkojne likujdimin e kuotave te trasheguara, shoqeria likujdon kuotat e pjesmarrjes se ortakut te vdekur, ne proporzion me pasurine e shoqerise. Likujdimi duhet te kryhet brenda 36 muajsh nga momenti i kerkeses per likujdim kuotash. Kuotat e likujduara shperndahen ne menyre te barabarte midis ortakeve te mbijetuar.

Neni 17/1

Terheqja e ortakut

Ortaku ka te drejte te terhiqet nga shoqeria ne cdo lloj momenti. Ortaku duhet te lajmeroje shoqerine per vendimin e tij per t'u terhequr nepermjet nje letre me lajmerim marrje, ku te jete percaktuar mire gjeneraliteti i ortakut, kuotat e mbajtura, nje adrese te sakte per komunikimet e metejshtme si dhe perskrimin e arsyeve qe legjitimojne kerkesen per t'u terhequr.

Neni 17/2

Largimi i ortakut

Me vendim assembleje ku te jene dakort te pakten ortaket qe kane 2/3 e kuotave te shoqerise, mund te largohet me arsye te drejte ortakut qe:

- 1) Edhe pse i detyruar te permbushe nje detyre apo sherbim specifik, nuk eshte me ne gjendje ta permbushe ate.
- 2) Eshte deklaruar i paafte per te vepruar me vendim te formes se prere.
- 3) Rezulton te mos kete permbushur detyrimet ndaj shoqerise.
- 4) Blen ne menyre direkte ose indirekte kuota kapitali te shoqerive konkurrenente pa aprovimin paraprak te ortakeve te tjere.

Neni 18

Shperndarja e fitimeve

Ortaket kane te drejte te ndajne pjeset e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise.

Neni 18/1

Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Neni 18/2

Viti ushtrimor fillon ne 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te çdo viti. Viti i pare ushtrimor fillon nga data e regjistrimit prane Q.K.B.-se dhe vazhdon deri ne 31 dhjetor 2017.

Neni 19

Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme mund te mblidhet dhe jasht selise se shoqerise, por gjithsesi brenda territorit shqiptar. Asambleja e pergjithshme, eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e mëposhtme:

- 1- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- 2- Ndryshimet e statutit;
- 3- Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- 4- Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- 5- Percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
- 6- Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- 7- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 8- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit;
- 9- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- 10- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- 11- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- 12- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- 13- Nisjen e nje hetimi te posaçem per parregullsite pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare, hetim ky i cili kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes;
- 14- Miraton bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve, dokumente keto te paraqitura nga administratori.
- 15- Vendos per likuidimin me nje procedure te pershpejtuar sipas nenit 25 te ketij statuti.
- 16- Çeshtje te tjera te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Neni 19/1

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme mbledhet te pakten nje here ne vit.

Asamblene e Pergjithshme, kane te drejte ta therrasin:

- 1- Administratori.
- 2- Ortaku qe zoteron te pakten 50% te kuotave.
- 3- Ortaket e pakices sipas nenit 84 te ligjit nr.9901.

Asambleja e Pergjithshme thirret ne menyre te vecante:

- a- Nese sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- b- Kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, pasuri te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
- c- Kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton nga pasqyrat e fundit te çertifikuara.

Ne rastet "a-" dhe "c-", te ketij neni, asamblese i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.

Ne rastet e mesiperme (a, b, c te ketij neni), asambleja mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo duke bere verejtje per veprimtarine e administratorit.

Neni 19/2

Menyra e thirrjes se asamblese

- I. Asambleja e Pergjithshme thirret permes nje njoftimi me shkrim.
- II. Asambleja e Pergjithshme thirret edhe permes njoftimit me ane te postes elektronike.
- III. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Ne zarin me te cilin dergohet njoftimi me shkrim apo çdo shkrese tjeter ne funksion te mbledhjes se asamblese, ne anen e jashtme te pasme te tij duhet te shkruhet detyrimisht nje permbledhje e sakte e dates se hartimit te shkreses qe gjendet ne permbajtje te letres, e titullit te kesaj shkrese, dhe e permbajtjes se njoftimit me te gjitha detajet e rëndësishme qe permban letra.
- IV. Njoftimi me shkrim i dergohet te dy ortakeve ne keto adresa me lajmerim marrje:

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

- 1- Altin Broshka – ne adresen : Mollas – Bashkia Cerrik
 - 2- Kostantinos Karavelos – ne adresen: Nea Moutania, Kalkidhiki. – Greece, Kodi Posta 181 ose ne adresen e-mail karavelaskwstas@gmail.com
- V. Nese asambleja thirret nga nje administrator i cili eshte njekohesisht ortak, atehere nuk eshte e nevojshme dergimi i njoftimit te thirrjes se mbledhjes, ortakut – administrator.
- VI. Nese ekziston nje vendim gjykate per pezullimin e te drejtave te ndonjerit prej ortakeve, atehere thirren vetem ortaket e tjere me te drejta te plota dhe vendimore. Nese nga ky vendim pezullimi, ka ngelur vetem nje ortak me te drejta ne shoqeri, dhe ky ortak eshte njekohesisht administrator, dispozitat mbi njoftimin e mbledhjes se asamblese nuk zbatohen, kur kjo mbledhje thirret nga ky administrator-ortak.
- VII. Ortaku i thirrur ne rast pamundesie absolute per pjesemarrjen ne mbledhje, mund ti drejtoje brenda 2 (dy) diteve nga marrja e njoftimit per thirrjen e asamblese se pergjithshme, administratorit apo ortakut te pakices (sipas nenit 84 te ligjit nr.9901), nje leter me shkrim ne adresen e deklaruar te administratorit apo ortakut te pakices qe ka thirrur mbledhjen, ku te shpjegoje arsyet e pamundesise se pjesemarrjes dhe te kerkoje shtyrjen e mbledhjes ne nje date te deshiruar nga ai jo me vone se 30 dite kalendarike nga marrja e njoftimit te pare per thirrjen e asamblese. Njekohesisht eshte i detyruar te bashkengjise prova shkruese origjinale ose te noterizuara, qe mbeshtetin arsyen e mospjesemarrjes. Ne mungese te ketyre provave kerkesa per shtyrjen e mbledhjes nuk konsiderohet dhe mospjesemarrja nuk do te pengoje mbledhjen e asamblese.
- VIII. Konsiderohet marrje njoftimi per efekt te ketij statuti, momenti qe sherbimi postar dergon letren tek marresi i njoftimit, ne adresat e deklaruar ne kete statut, pavaresisht dates se dorezimit ne sherbimin postar te njoftimit nga personi qe kryen njoftimin, dhe nese marresi i njoftimit e merr ne dorezim letren apo e refuzon ate.
- IX. Detyren dhe pergjegjesine per t'i shpjeguar sherbimit postar procedurat e siperpermendura, e ka personi qe dergon njoftimin.
- X. Njoftimi i mbledhjes, apo komunikimi mes adminstratoreve dhe ortakeve apo mes ortakeve, mund te behet edhe nepermjet postes elektronike, ne keto adresa te postes elektronike:
- 1- Altin Broshka – ne adresen :
 - 2- Kostantinos Karavelas – ne adresen: karavelaskwstas@gmail.com

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

- XI. Njoftimi me poste elektronike sipas pikes "X" te ketij neni, duhet te permbaje elementet e percaktuar ne paragrafin "III" te ketij neni. Njoftimi duhet te dergohet nga adresa e postes elektronike e deklaruar ne statut te administratorit apo ortakut, i cili therret mbledhjen, ne drejtim te adreses elektronike te deklaruar ne statut, te ortakut i cili po njoftohet. Komunikimi me poste elektronike i çfaredo natyre qofte, me adresa te padeklaruara dhe te pashenuara ne statut nuk do te konsiderohet i vlefshem. Marrja e njoftimit konsiderohet i kryer qe ne momentin e dergimit te njoftimit nga adresa e postes elektronike te derguesit. Per efekt vertetimi te njoftimit nepermjet postes elektronike dhe perdorimit te ketij njoftimi, derguesi apo marresi mund te printoje pamjen vizuale te faqes se kompjuterit qe pasqyron njoftimin e derguar, printim i realizuar ne prezence te nje noteri te licensuar ne Republiken e Shqiperise. Noteri ne kete rast me procesverbal verteton faktin se nga adresa e postes elektronike te derguesit (duke specifikuar adresen e postes elektronike), eshte derguar ne adresen e postes elektronike te marresit te njoftimit. Njoftimi perkates me permbajtjen e njoftimit te cituar ne procesverbal, ne daten e caktuar. Fshirja pa dashje ose me dashje e mesazheve ne adresen e postes elektronike nuk mund te pretendohet nga palet si justifikim per mosekzistencen e njoftimit ne rubriken e postes elektronike te mesazheve te derguara apo te marra.
- XII. Mosrespektimi i procedurave te njoftimit te mesiperme e ben njoftimin te pavlefshem.
- XIII. Nese asambleja nuk eshte thirrur sipas rregullave te percaktuara me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët janë prezent ne mbledhje dhe janë dakord per te marre vendime.
- XIV. Pjesemarrja e ortakeve ne mbledhjen e asamblese mund te behet e mundur edhe me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.
- XV. Ortaket mund te perfaqsohen ne mbledhjen e asamblese nga persona te trete te paisur me prokure noteriale. Kjo prokure depozitohet prane shoqerise dhe ruhet nga ajo.

Neni 19/3

Procesverbali i mbledhjes mbahet gjithmone nga nje Noter i licensuar ne Republiken e Shqiperise.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Ne rastet kur prezent ne mbledhjen e asamblese jane te gjithë ortaket e shoqerise, nuk eshte e nevojshme mbajtja e procesverbalit perpara noterit, por kete procesverbal e mban administratori apo ortaku i cili ka thirrur mbledhjen.

Caktohet kryetar nenshkruer i procesverbalit administratori qe e ka thirrur mbledhjen, apo ortaku sipas nenit 84 te ligjit nr.9901. Ne rastet kur pjesemarrës ne mbledhje jane te gjithë ortaket, dhe procesverbali mbahet nga administratori apo ortaku i pakices, sipas paragrafit te mesiperm, kryetar nenshkruer caktohet ortaku me i vjeter ne moshe dhe ne rast se ky ortak perkon me mbajtesin e procesverbalit, atehere kryetar nenshkruer caktohet ortaku tjeter me i vjeter ne moshe.

Procesverbali nenshkruhet nga kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarrësve dhe akti i thirrjes se Asamblese.

Nese ne mbledhjen e asamblese jane te gjithë ortaket e shoqerise prezent nuk eshte e nevojshme t'i bashkelidhet procesverbalit akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.

Vertetimi i prezences se ortakeve ne mbledhjen e asamblese kryhet me vendosjen ne aktin e veçante te listes se pjesemarrësve te shenjes se gishtit tregues te dorës se djathte, te lyer me boje blu, dhe nenshkrimin e ortakut me emer, mbiemer, dhe firme, perbri shenjes se gishtit te tij.

Neni 19/4

Nese mbledhja e asamblese nuk respekton rigorozisht procedurat e parashikuara ne nenet 19/2 dhe 19/3 te ketij statuti, ajo nuk mund te marre asnje vendim te vlefshem.

Neni 20

Marrja e vendimeve

Ne lidhje me vendimet per:

- 1- Ndryshimin e statudit.
- 2- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar.
- 3- Shperndarjen e fitimeve.
- 4- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

asambleja vendos me te pakten 3/4 e votave te ortakeve pjesemarrës ne mbledhjen e asamblese.

Ne lidhje me vendimet e tjera, te renditura ne nenin 19 te ketij statuti, asambleja vendos me shumicen e thjeshte te votave te ortakeve pjesemarrës.

Te gjitha vendimet e asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal, ne perputhje me kushtet dhe rregullat e percaktuara ne nenin 90 te ligjit nr.9901.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Neni 20/1

Kuorumi

Per vendimet qe neni 20 i ketij statuti kerkon shumice te cilesuar prej 3/4 te votave, asambleja nuk mund te marre vendime te vlefshme nese ne mbledhje nuk jane prezent personalisht ortaket qe zoterojne te pakten me shume se gjysmen e kuotave me te drejte vote ne shoqeri.

Per vendimet qe neni 20 i ketij statuti kerkon shumice te thjeshte, asambleja nuk mund te marre vendime te vlefshme nese ne mbledhje nuk jane prezent personalisht ortaket qe zoterojne te pakten me shume se 30 % (tridhjete perqind) te kuotave me te drejte vote ne shoqeri.

Neni 20/2

E drejta e votes

Çdo kuote jep te drejten e nje vote. Kuotat jane 100 dhe vlera nominale e cdo kuote eshte 100 lek.

Nje ortak mund te perjashtohet nga e drejta e votes ne rast se Asamblea e ortakeve:

- a) Ben vlersimin e veprimtarise se ortakut;
- b) Merr vendim per shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) Merr vendim per ngritjen e ndonje padie ndaj tij nga ana e shoqerise;
- d) Merr vendim per dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Neni 21

Te drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet qe:

- 1- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- 2- Te perfaqesoje shoqerine tregtare;
- 3- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- 4- Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- 5- Te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- 6- Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sipas ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuarkj.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

- 7- Te raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- 8- Nese jane emeruar dy ose me shume administratore, keta e administrojne bashkerisht shoqerine. Asambleja e Pergjithshme me vendim te veçante, mund te percaktoje qe te kete rradhe hierarkike ne administrim, nga administratore te caktuar duke specifikuar rrethanat e kesaj perparsie ndermjet administratoreve.
- 9- Ne rast likuidimi ne gjendjen e aftesise paguese, i njofton per regjistrim QKR-se te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre.
- 10- Te hape llogari bankare prane institucioneve financiare, te kryeje prane ketyre institucioneve te gjitha operacionet per llogari te shoqerise, te marre hua nga keto institucione vetem per mbarevajtjen e aktivitetit te shoqerise.
- 11- Administratorit i ndalohet te terheqe me teper se 1.000.000 (nje milion) leke, nga llogaria bankare e shoqerise per nje periudhe me te vogel se 2 muaj. Terheqjet qe administratori do te kryeje nga llogaria bankare e shoqerise detyrohet ti dokumentoje me shkrim ne lidhje me destinacionin e tyre dhe arsyet e kesaj terheqjeje. Shkresat perkatese te realizuara me kete qellim, administratori eshte i detyruar ti ruaje dhe t'i dorezoje tek ortakët ne fund te çdo muaji duke i informuar ata ne lidhje me keto terheqje, sipas dispozitave te parashikuara ne lidhje me njoftimin ne nenin 19/2 te ketij statuti. Barren e proves qe ky informim eshte realizuar e ka administratori.
- 12- Ne lidhje me veprimet ne kassen fiskale te shoqerise administratori ka te drejta te pakufizuara. Veprime financiare jashte llogarise bankare te shoqerise dhe jashte kases fiskale te shoqerise, administratori i ka te ndaluara ti kryeje. Ne lidhje me shumat financiare te arketuara nga kasa fiskale e shoqerise administratori eshte i detyruar qe keto shuma t'i kaloje ne llogarine bankare te shoqerise brenda 1 (nje) jave kalendarike nga data e arketimit te ketyre shumave monetare, ose t'i riinvestoje ne aktivitetin e shoqerise.

Neni 21/1

Pergjegjesite e administratorit

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

STATUTI I SHOQËRISË "EUROMONTANA" SHPK

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 22

Shpërblimi i administratoreve

Shpërblimi i administratorit përcaktohet me vendim të zakonshëm të Asamblese se Përgjithshme.

Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i pershtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratoreve në masën e pershtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratoreve në strukturën e kostove të shoqërisë publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 23

Emerimi i likuiduesit

Në rast se asambleja e përgjithshme vendos për likuidimin e shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese, ajo është e detyruar të caktojë likuiduesin, brenda 30 ditëve pas marrjes së vendimit.

Në caktimin e likuiduesit duhet të kihet parasysh se ky caktim nuk duhet të paraqesë arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesi i caktuar.

Neni 23/1

Te drejtat dhe detyrat e likuiduesit

Likuiduesi merr përsiper të drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit të tij.

Kufizime të caktuara për veprimtarinë e likuiduesit, mund të vendosen nga ortakët i vetëm në aktin e emerimit të likuiduesit. Këto kufizime publikohen në mënyrë elektronike sipas nenit 61 të ligjit nr. 9723 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit" dhe kanë efekt edhe ndaj të tretëve duke u quajtur të njohura publikisht në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 9901.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Likuiduesi ka detyre te ftoje kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e shoqerise.

Detyrat kryesore te likuiduesve jane:

- 1- Mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise.
- 2- Mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera.
- 3- Shitja e pasurive te shoqerise.
- 4- Shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e preferimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 5- Kryerja e veprimeve te reja tregtare ne funksion te mbylljes se nje veprimi te paperfunduar.

Kur likuiduesit vejne re se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e pretendimeve te ngritura nga kreditorët, likuiduesi pezullon proceduren e likuidimit dhe i kerkon gjykates nisjen e procedurave te falimentimit.

Neni 24

Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditoreve, likuiduesi i shperndan ortakeve aktivet e mbetura.

Neni 25

Likuidimi i thjeshtezuar

Me vendim te saj, asambleja e pergjithshme mund te vendose per likuidimin e pershpejtuar.

Me marrjen e ketij vendimi dhe regjistrimin e tij te rregullt ne regjistrin e vendimeve, sipas kritereve te ketij statuti, asambleja e pergjithshme eshte e detyruar te deklaroje perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditoreve jane shlyer e jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemarresit.

Administratori i shoqerise njofton per regjistrim prane QKR-se vendimin e mesiperem.

Administratori dhe ortaket, jane pergjegjes solidarisht, per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar.

Neni 26

Dispozita te fundit

Per cdo mosmarrveshje te mundshme midis ortakeve ose per interpretimin dhe ekzekutimin e ketij statuti, gjykata kompetente eshte Gjykata e rrethit Gjyqesor Elbasan.

STATUTI I SHOQERISE "EUROMONTANA" SHPK

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do t'i referohemi Kodit Civil, Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe ligjeve te bashkelidhura.

Ky statut hyn ne fuqi me regjistrimin e tij prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Ky statut perpilohet ne gjuhen shqipe ne 3 kopje, ku nje kopje te statutit e mban z. Altin Broshka, nje kopje e mban z. Kostantinos Karavelas dhe nje kopje depozitohet prane selise se shoqerise. Pasi u lexua nen per nen, u miratua ne parim dhe nen per nen si dhe u nenshkrua nga ortaket.


Miratuar me vendim unanim te Asamblese se Pergjithshme me numer 1, date 03/07/2017.


Ortaket

e Shoqerise "EUROMONTANA" Shoqeri me Peggjjesi te Kufizuar

Altin Broshka

Kostantinos Karavelas


Altin Broshka


Kostantinos Karavelas